

Në Planin e Atit Qiellor, si Gratë edhe Burrat Janë të Domosdoshëm

MANUALI I SEMINARIT PËR DHATËN E RE

Përzgjidh një nga skenarët vijues dhe mendo se si zbatimi i parimeve të marrjes së njohurisë shpirtërore mund ta ndihmojë dikë të kuptojë të vërtetën nga vargu te 1 Korintasve 11:11 për rolet e burrave dhe grave në planin e Atit Qiellor.

1. Motra më e vogël e Kelit, Eli, dëgjoi disa djem në shkollë të thoshin se burrat janë më të rëndësishëm se gratë. Eli e pyet Kelin: “A nuk vlej unë po aq sa djemtë?”
2. Redi është i shqetësuar sepse ai dëgjon disa nga anëtarët e tjerë të kuorumit të flasin pa respekt për gratë.
3. Pasi shohin një film të famshëm, një grup shoqesh tallen me veprimet qesharake të personazhit të babait. Disa bien dakord se babai nuk ishte i nevojshëm dhe një shoqe thotë: “Kjo është arsyeja përse nuk të duhet një burrë për të krijuar një familje të lumtur”.
4. Gerti dhe Klara po përgatiten për t’u martuar në tempull. Prindërit e tyre sugjerojnë që ata të flasin për mënyrën se si secili do t’i përmbushë rolet dhe përgjegjësitë e ndryshme në familjen e tyre të ardhshme.

Vepra me Besim

- Cilat janë mënyrat se si ti ose individi në skenar mund të vepronin me besim si përgjigje ndaj problemit të ngritur?
- Si mund të të ndihmojë vlerësimi i roleve unike dhe domosdoshme të grave dhe burrave ta ndjekësh Jezu Krishtin?

Shqyrtoji konceptet dhe pyetjet me një këndvështrim të përgjithshëm

- Çfarë di ti për Atin Qiellor dhe planin e Tij që mund të jetë e dobishme po të përballësh me një situatë si kjo?
- Cilët janë disa nga rolet e burrave dhe grave në planin e Atit Qiellor?

Kërko informacion të mëtejshëm nëpërmjet burimeve të caktuara në mënyrë hyjnore

- Si mundet që kuptueshmëria dhe dëshmia jote për të vërtetat e dhëna mësim te 1 Korintasve 11:11 të të ndihmojnë të reagosh ndaj kësaj situatë?
- Cilat mësim të tjera të frymëzuara nga shkrimet e shenjta ose udhëheqësit e Kishës mund të të ndihmojnë të reagosh me besnikëri?